

**VENDIM**  
**Nr.644, datë 16.6.2010**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE TË MASËS SË TRAJTIMIT TË  
VEÇANTË FINANCIAR TË PILOTËVE E TË TEKNIKËVE FLUTURUES TË NJËSISË  
SË TRANSPORTIT MJEKËSOR ME HELIKOPTER, NË PENSION**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 8 të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Piloti/tekniku i interesuar, për efekt të llogaritjes, caktimit dhe pagesës së shtesës mbi pension, si trajtim i veçantë financiar, të tërheqë nga dega e sigurimeve shoqërore dy formularë kërkesë për përfitim, të cilat i dorëzon, përkatësisht, në Njësinë e Transportit Mjekësor me Helikopter, ku ka punuar deri në ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, dhe në degën e sigurimeve shoqërore ku ka vendbanimin.

Dokumentacioni i nevojshëm për përfitimin e trajtimit të veçantë të përgatitet nga Njësia e Transportit Mjekësor me Helikopter dhe t’i dërgohet Ministrisë së Shëndetësisë, e cila pasi e shqyrton, ia dërgon degëve përkatëse të sigurimeve shoqërore.

2. Për llogaritjen e trajtimit financiar të merret si bazë paga referuese, e njehsuar me pagën referuese të funksionit organik të pilotit ose të teknikut aktiv në Njësinë e Transportit Mjekësor me Helikopter, në të njëjtën detyrë me përfituesin, në çastin e lindjes të së drejtës për këtë trajtim financiar.

Paga referuese për përfituesin përfshin:

- a) Pagën e grupit;
- b) Shtesën për vjetërsi;
- c) Shtesën për kualifikim;
- ç) Shtesën për pozicion;
- d) Shtesën për kushte pune;
- dh) Shtesën e fluturimeve vjetore.

3. Për efekt të vendosjes në kushtet e përfitimeve, sipas nenit 4 të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar, personat, që kanë fluturuar me avionë me helikë, barazohen me personat që kanë fluturuar me helikopterë.

4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për hartimin e udhëzuesit dhe të dokumentacionit tip për zbatimin e këtij vendimi.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i viteve përkatëse, të miratuara për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

6. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.10135, datë 11.5.2009 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**